



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 458/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Bashkimit Demokratik (BD), dega në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, rreth orës 10:30 në Qendrën Votimit në Vlashne, 2 vetura njëra me targa 161-BO- "Golf 2", me emër të panjohur si dhe vetura tjetër të cilën e ngiste Gentian Krasniqi, që të dy anëtar të BD-së me flamuj dhe pankarta të DD-së, qarkullimin për disa herë rreth e rreth qëndresë zgjedhore të Sh.F.. në Vlashë, duke brohoritur për BD-në, në kundërshtim me nenin 4.1 pika k të Rregullores 11/2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa e subjektit politik PDK, është e pabazuar ngase nuk ka asnjë provë relevante për ti vërtetuar pretendimet ankimore, prandaj se një pretendim i ankesës është i pa argumentuar dhe i pa bazuar në fakte dhe prova dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 458/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*